



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 75, datë 20.02.2020

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARES NË SKEMËN E DELEGIMIT
ZNJ.{...}, NË GJYKATËN E APELIT KORÇË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a” të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës aktuale dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Korçë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.{...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.09.2020.
2. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.{...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.04.2020.
3. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së skemës së delegimit, znj.{...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR